


BASHKIM KOPLIKU

“Berisha, rreziku më i madh i shqiptarëve”

[Botuar në gazetën Korrieri, dt. 8.8.2006, intervistë e shkruar nga një intervistë televizive në TVA (datë 6.8.2006), nga gazetari Aklet Aliu. Teksti në vijim është skanuar me OmniPage Program. Mendimet janë dhënë siç i kam thënë, por është ndërruar stili i shprehjeve të mia.-B.K.]



Ish numri 2 i qeverisë së parë të Partisë Demokratike, në apartamentin e tij modest në Durrës, shprehet i gatshëm të japë një intervistë për "Korrierin", ku të flasë për aktualitetin politik në vend. Por dhe për vitet që la pas në strukturat më të larta drejtuese të shtetit. Një ndër ato gjëra që të impresionojnë në studion e tij është biblioteka jashtëzakonisht e pasur me tituj në disa gjuhë. Nga inxhinier elektronike në URT-në e Durrësit në politikan, Zëvendëskryeministër e Ministër i Brendshëm, për të kaluar pas vitit 1997 në analist të pavarur. Është kjo karriera e njeriut, dritat e studios së të cilit, për më se 30 vjet janë fikur vetëm pas mesnatës.

Ndonëse analizat dhe komentet e tij janë të shumta në median e shkruar, ish-zv.kryeministri i qeverisë së parë të PD-së, Bashkim Kopliku, rrallë ka folur për jetën politike dhe profesionale. Në një bisedë me "Korrierin", shpjegon pse është kundër Berishës dhe argumentet, pro ministrit të Brendshëm Olldashi

Z.Kopliku, cilat janë tashmë raportet tuaja me politikën?

U bënë 9 vjet që nuk merrem më me politikë aktive. Tani po mësohem me idenë

e të qenit pensionist. Ka kaluar shumë kohë. Idealet nuk janë më ato të dhjetorit '90. Nuk e shoh më veten në partinë time të dikurshme, PD-në. Më ka mbetur roli i analistit.

Çfarë mendoni se mungon aktualisht në shtypin shqiptar?

Tani vetëm shkruaj dhe mundohem të them të vërtetën, madje e konsideroj një detyrë patriotike të them të vërtetën në mizërinë e faqeve të mbushura përditë me hipokrizi, me gënjeshtër, e mashtrime. Mundohem të arrijë një rreth të gjerë lexuesish, prandaj mundohem të jem i thjeshtë e i kuptueshëm. I verifikoj me vajzën time 10 vjeçe, shkrimet para se t'i nis në gazetë: Në qoftë se i kupton, atëherë them se ia kam arritur qëllimit.

Nëse në shumë raste nuk thuhet e vërteta, nga vjen kjo?

Që të thuash të vërtetën më së pakëti duhet të jesh i lirë. Ndonëse është abroguar prej 15 vjetësh neni i famshëm 55 i agjitacionit e propagandës dhe pavarësisht nga deklaratimet e bujshme se në Shqipëri nuk ka më censurë, ajo vetëm sa ka fshehur kokën. Politika gjen njëmijë mënyra për t'u bërë presion pronarëve të mediave dhe po të shohësh me kujdes nuk është se janë aq të pavarur sa duket. Ky lloj presioni, pas censurës së fshehur çon në autoçensurë, pasi nuk kanë qenë të paktë ata pronarë, redaktorë apo gazetarë që e kanë provuar në kurrizin e tyre ç'do të thotë t'u kundërvihesh përfaqësuesve politikë të shoqërisë sonë "demokratike".

A kan dryshuar diçkanë politikën e djathtë pas 8 vitesh opozitë?

E gjithë politika e PD-së ka ndryshuar dhe nuk funksionon më si parti e djathtë, por është zhvendosur drejt ekstremit të majtë. Nuk shoh sot ndonjë ndryshim të madh ndërmjet politikës së Berishës dhe të Nanos. Edhe Berisha, sikundër paraardhësi i tij, mendon se si të menaxhojë ndërmarrjet shtetërore në vend që të procedojë me shpejtësi drejt privatizimit të ndërmarrjeve të mëdha. Fatkeqësisht nuk ka asnjë parti politike në Shqipëri që të bëjë politikë të djathtë dhe ky është një vakum politik që nuk po mbushet. Në qoftë se sot nuk angazhohem në politikë, jo sepse nuk kam ende kontribute për të dhënë, por thjesht nuk kam më një parti ku të bëj pjesë.

Por përveç PD-së ka edhe parti të tjera të deklaruara "të djathta"?

Të gjitha marrin urdhra nga Berisha. Nuk është origjina që të bën të djathtë. Mund ta kesh pasur gjyshin ballist apo zogist, mund të kesh vuajtur në burgje e internim, por përderisa mentaliteti i politikëbëijes nuk është i djathtë, është e kotë të deklarohesh si i tillë. I djathtë nuk do të thotë të jesh antikomunist, se antikomunistë janë edhe të majtët evropianë.

A ka fajtor për këtë politikë që e quani "të keqe"?

Faji është i shqiptarëve. Unë jam me parimin se çdo popull meriton qeverinë që ka. Politika tanë janë të këqij sepse populli i do të tillë, ndryshe nuk do t'i votonte. Është e kotë kërkojmë fajin gjetkë, apo siç bëjnë disa duke akuzuar të huajt për situatën në Shqipëri. Unë them se fajtorë jemi vetë dhe është mirë që të ndërjegjësohemi për këtë. Ashtu sikurse i sëmuri që duhet ta dijë diagnozën përpara se sa të marrë rnjekimin e përshtatshëm, ashtu edhe ky popull duhet ta kutojë së pari se nga vjen e keqja.

Nga pozitrat e ish ministri të brendshëm, si e gjykoni punën e ministrit aktual Olldash?

Respektoj punën shumë të mirë të z.Oldashi dhe mund të them se është ndër ministrat e paktë që punon vërtet. Në përpjithësi në fushën e luftës kundër krimit është bërë një punë vërtet e lavdërueshme. Natyrisht që mund të ketë edhe gabime, pasi kush punon edhe gabon.

Largimi juaj nga skena politike u shoqërua me jo pak debate mbi demokracinë e brendshme në PD...

Është e vërtetë, dua të theksoj se nuk kam ikur vetë nga politika, është ajo që më ka flakur jashtë. Ajo që është më e dhimbshme është se jam flakur nga shokët e mi me të cilët kam ndarë idealet e dhjetorit. Berisha ishte vetëm një person, ishin shumë të tjerë që nuk reagueshin. U përjashtova nga Kryesia e PD-së (1997), me votat e po kryesisë, të po kolegëve të mi, gjë që natyrisht është në shkelje të statutit dhe të principeve bazë: anëtarët e kryesisë, natyrisht edhe unë, zgjidhen nga Këshilli Kombëtar i PD-së dhe jo nga kryesia, pra ajo nuk ka të drejtë të shkarkojë anëtarin e vet, e natyrisht as mua. Po kështu, presidenti Berisha, komunikoi vendimin e tij që të përjashtohesha nga grupi parlamentar i PD-së, gjë që nuk ishte kompetencë e presidentit, pra ishte një shkarkim krejt i paligjshëm. E theksoj, shokët e mi të PD-së, nuk iu kundërvunë këtyre shkeljeve flagrante: Veç erdhën e më qanë hallin personalisht e në fshehtësi.

Nga presidenti Berisha, te kryeministri Berisha. A inendonit se ka ndonjë ndryshim?

Berisha është rreziku më i madh i Shqipërisë dhe i shqiptarëve. Fajtori kryesor për ngjarjet e '97-s nuk mund të riciklohej sërish në politikë. Nuk ndodh në asnjë vend të botës së qytetëruar ajo që ndodh këtu në Shqipëri ku njerëzit uzurpojnë skenën dhe, me gjithë papërgjegjshmërinë e tyre, nuk i nxjerr dot njeri më jashtë.

Kush është Bashkim Kopluku

2006-2003: Publicistikë, mbi 200 shkrime, analiza dhe opinione në "Korrieri" si dhe në pjesën më të madhe të përditshmeve të tjera shqiptare.

2001 - 2004: Aktivitet privat në vlerësime financiare dhe ekonomike Këshilli i mi i investitorëve privatë për optimalizimin e projekteve nëpërmjet inxhinieringut ekonomik; vlerësime financiare, ekonomike dhe teknike; menaxhim i marrëdhënive me jashtë me furnitorët e pajisjeve.

1998-2001: World Bank-International Finance Corporation (IFC), Këshilltar për zhvillimin e projektit dhe për investimin Kryerje e vlerësimeve financiare dhe teknike të projekteve të mundshme dhe dhënie këshillim përfirmat evogla dhe të mesme, në drejtim të zhvillimit dhe të administrimit financiar të firmave.

1991 -1997: Pjesëmarrje në Ekzekutiv dhe në Legjislativ të Shqipërisë:

Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Rrethit të Durrësit (1991-1992); Deputet i Kuvendit

(1991-1997), Zëvendës Kryetar i Këshillit të Ministrave dhe Ministri i Rendit Publik (1992-1993),

Zëvendës Kryetar i Këshillit të Ministrave i ngarkuar me Reformën Ekonomike (1993-1995); Kryetar i Komisionit Përiamendues Ekonomik, Financës dhe Privatizimit (1996-1997). Drejtoi reformat që vendosën ligjin dhe rendin e brendshëm; përmirësoi efektivitetin e administratës publike; paragjiti dhe zbatoi aktet ligjore dhe nënligjore që realizuan një privatizim të shpejtë të mijëra ndërmarrjeve.

1991-1997: Anëtar i Partisë Demokratike Shqiptare

Anëtar i kryesisë së PD (1991-1997); Kryetar i Departamentit Ekonomik pranë PDSH (1995-1997)

Qe njëzë i pavarur brenda PDSH; kontribuoi kryesisht në programimin e reje formave ekonomike të zbatuara gjatë viteve 1991-1997; I është kundërvënë PDSH për piramidat financiare, që në fillimin e vitit 1996.



Kopliku me Berishën, në 70-vjetorin e Policisë së Shtetit

Linguisti që ha shëtitur botën

Diplomuar si inxhinier elektronik në Universitetin e Tiranës, më 1966, Bashkimi Kopliku ka kryer disa kurse kualifikimi për vlerësime financiare të projekteve dhe firmave. Në këtë kuadër si dhe atë politik, Kopliku ka vizituar në periudha dhe kohëzgjatje të ndryshme, thuajse të gjitha vendet e Evropës, si dhe SHBA, Pakistan, Malajzi, Kinë, Tunizi, etj. I martuar dhe me tre fëmijë, 63 vjeçari Kopliku njihet shumë mirë gjuhë të huaja si anglisht, gjermanisht, italisht, rusisht e frëngjisht.

Bisedoi Alket Aliu